



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korruptsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korruptsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korruptsionit, duke vepruar pas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur-.....SHPKNJP....., në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura e udhëhequr nga lënda e formuar pas denoncimit të paraqitur nga parashtrues i njohur – SHPKNJ....., deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korruptsionit, në bazë të së cilit është formuar lëndë me numër 12-5577/1 nga viti 10.12.2019, tek i cili theksohet për dyshime për shkelje ligjesh dhe veprime të korruptuara të kryera nga ana e Komunës së gjatë dhënies së kontratës për furnizim publik për mirëmbajtje dimërore të rrjetit rrugor në Komunën e për vitin 2018/2019 **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korruptsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korruptsionit pas kontrollit të përmbajtjes së denoncimit dhe dokumentacionit shtesë të marrë konstaton se nuk ka elemente për veprim kompetent të mëtutjeshëm për lëndën nga shkakut e denoncimit nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 12-5577/1 nga viti 10.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK në afat prej 5(pesë) ditësh nga dita e vendimmarrjes.

Sqarim

Lënda me numër 12-5577/1 nga viti 10.12.2019 është formuar në bazë të denoncimit të arritur nga parashtrues i njohur-SHPKNJP.....

Në denoncim theksohet për dyshime për shkelje ligjesh dhe veprime të korruptuara të kryera nga ana e Komunës gjatë dhënies së kontratës për furnizim publik për mirëmbajtje dimërore të rrjetit rrugor në Komunën për vitin 2018/2019. Në denoncim theksohet se për këtë furnizim është publikuar shpallje për procedurë të hapur, të cilën Komisioni shtetëror për ankesa në furnizime publike e ka anuluar, por nuk ka qenë e publikuar shpallje e përsëritur, mandej komuna ka lidhur marrëveshje për mirëmbajtje dimërore në procedurë me negocim pa publikim të mëparshëm të shpalljes me qëllim të favorizimit të operatorit ekonomik të caktuar. Gjithashtu, në denoncim theksohet dyshim se për këtë furnizim komuna vazhdimisht e përzgjedh operatorin ekonomik të njëjtë, si dhe qëllimisht zbaton procedurë të shkurtër në periudhë të dimrit në vend që më herët përgjatë vitit të publikon shpallje, ndërsa e gjitha me qëllim të favorizimit të operatorit ekonomik të caktuar. Për fund theksohet se çmimet e shërbimeve nga ky operator ekonomik çdo vit kanë dallim në

krahasim me vitet paraprake që edhe më shumë tregon se mund të bëhet fjalë për keqpërdorim të qëllimshëm, harxhim në mënyrë jo transparente dhe jo të ligjshme të mjeteve për furnizim publik të Komunës.....

Për shkak të kontrollit të akuzave dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike për lëndën e hapur, Komisioni shtetëror kërkoi nga Komuna të dorëzon informatë të plotë me dokumentacion të bashkangjitur për furnizimet publike të zbatuara për mirëmbajtje dimërore të rrugëve dhe udhëve për vitin 2017, 2018 dhe 2019 edhe atë në lidhje me të mëposhtmet:

- Plane vjetore për furnizime publike,
- Të shpjegohen arsyet dhe justifikimi për zbatim të llojit të caktuar të procedurës për furnizim publik,
- Dokumentacioni i plotë nga procedurat e zbatuara për furnizime publike,
- Nëse pas përcaktimit të zgjedhjes së ofertës më të favorshme janë dorëzuar ankesa kundër këtyre vendimeve dhe cili ka qen përfundimi nga këto procedura.

Nga marrëveshja e dorëzuar në afat ligjor të parashikuar me bashkëngjitje të dokumentacionit të kërkuar nga Komuna është konstatuar si vijon:

-Për vitin 2017 Komuna në planin vjetor për furnizime publike me nr. 14-1101/1 nga viti 31.01.2017 e ka parashikuar furnizimin e mirëmbajtjes dimërore në shtator, ndërsa para se të shfaqet shpallja është kryer analizë e tregut dhe në të njëjtën kohë janë ftuar operatorët ekonomik që kur të paraqitet shpallja të dorëzojnë oferta. Për kriteret e përcaktuara është marrë përgjigje kthyesë se të njëjtat i plotësojnë 6 operatorë ekonomik, ndërsa në shpalljen publike të publikuar në SEFP dhe Gazetën Zyrtare të RM janë dorëzuar dy oferta të pranueshme (nga parashtruesi i denoncimit dheSHPNJP.....) që rezulton në lidhje të marrëveshjes meSHPK në përputhje me Ligjin për furnizime publike, dhe në përputhje me kriterin për dhënie të marrëveshjes- çmimi më i ulët;

-Për vitin 2018 Komuna në planin vjetor për furnizime publike për vitin 2018 me nr. 14-1291/1 nga viti 31.01.2018 furnizimi i mirëmbajtjes dimërore ka qen i parashikuar në muajin shtator dhe është publikuar shpallje në SEFP dhe Gazetën Zyrtare të RM për dhënie të marrëveshjes për furnizim publik pas procedurës së hapur tek e cila si ofruer është paraqitur vetëmDOO Për këtë procedurë është ngritur ankesë deri tek Komisioni shtetëror për ankesa në furnizime publike për dokumentacionin e tenderit dhe pas ankesës është sjell Vendim në vitin 11.12.2018 me anë të së cilit është anuluar procedura dhe dokumentacioni i tenderit. Organi kontraktues Komuna veproi pas vendimit të KSHAFP dhe e ka anuluar procedurën për furnizim publik e cila ka qenë në fazë të vlerësimit.

Më pas është nisur procedurë me negociim pa u paraqitur shpallje e mëparshme në bazë të nenit 99 paragrafit 1 pika 1 alinea 3 nga Ligji i vlefshëm për furnizime publike - nga arsye të urgjencës së skajshme të iniciuara nga ngjarje të cilat organi kontraktues nuk ka mundur që t'i parashikon dhe t'i përshkruhen si lëshim, nuk mund të aplikohet afati për publikim të procedurës së hapur ose procedurë me negociim me publikim të shpalljes, ndërsa për shkak se sezoni i dimrit ka qen i nisur e që ka shkaktuar vështirësi në komunikacion në territorin e Komunës të cilët kanë kërkuar intervenim urgjent.

Ftesë për parashtrim të ofertave është dorëzuar tek 3 operatorë ekonomik të cilët e kanë pranuar ofertën dhe kanë dërguar oferta në procedurë. Në procesverbalin nga negocimi janë të paraqitura çmimet e ofruara nga ana e ofruesve, por është konstatuar se asnjëri nga ata nuk është paraqitur në mbledhjen e caktuar për negociim dhe për atë shkak komisioni pas kryerjes së vlerësimit ka konstatuar se ofertën fillestare më të favorshme e ka dorëzuar operatori ekonomik SHPK (i cili dukshëm ka ofruar çmim më të ulët) dhe deri tek i njëjti është dorëzuar ftesë për të parashtruar ofertë përfundimtare, ndërsa më pas është marrë vendim për përzgjedhje të ofertës më të favorshme dhe është lidhur marrëveshje për furnizim publik;

-Për vitin 2019 furnizimi për mirëmbajtje dimërore është parashikuar në planin vjetor për furnizime publike me nr.14-1089/1 nga viti 30.01.2019 në tetor. Procedura ka qenë e zbatuar në formë elektronike të publikuar në SEFP dhe Gazetën Zyrtare tek e cila kanë marrë pjesë 3 ofrues. Oferta ka qenë e ndarë në dy pjesë dhe për çdonjëren pjesë ka qenë e lidhur marrëveshje e veçantë, ndërsa është ndarë në dy individ juridik të ndryshëm në përputhje me kriterin për çmim më të ulët, dhe pas zbatimit të ankandit elektronik veçmas për çdonjëren pjesë në përputhje me Ligjin e vlefshëm për furnizime publike. Për pjesën e parë të lëndës në furnizim është lidhur marrëveshje me SHPK, ndërsa për të dytin me SHPKNJP.....

Sa ju përket akuzave që çmimet e ofertave të operatorëve ekonomik të përzgjedhur, çdo vite kanë dallim të madh në raport me vitet paraprake, nga ofertat e ofruara nga ky ofrues, por edhe nga të tjerët të cilët kanë marrë pjesë në procedurat në tre vitet e fundit, konstatohet që çmimet e tij dallohen për vlerë minimale krahasuar në që të tre vitet si dhe krahasuar me ofruesit e tjerë.

Në bazë të gjendjes së tillë faktike të vërtetuar, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vlerësoi që nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm pas lëndës në përputhje me nenin 17 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nga shkak se akuzat në denoncim nuk janë të vërtetuara.

Duke e pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19), vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pas mbarimit të seancës së KSHPK:
Punoi: mr B.K.SH., këshilltarë
Miratoi: S.P.D., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROK PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetar: Biljana Ivanovska